



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
ENTI RREGULLATOR I ENERGJISË
BORDI

VENDIM

Nr. 257, Datë 23.08.2023

MBI

**DISA NDRYSHIME NË VENDIMIN E BORDIT TË ERE-S NR. 195, DATË 30.08.2018,
“MBI LICENCIMIN E SHOQËRISË “DERBI-E” SH.P.K., NË VEPRIMTARINË E
PRODHIMIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE NGA HEC “ANTENA” ME KAPACITET
TË INSTALUAR 1105 KW**

Në mbështetje të nenit 16 të ligjit nr. 43/2015 “Për sektorin e energjisë elektrike”, i ndryshuar; nenit 113 të ligjit nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”; si dhe nenit 15 të Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s, miratuar me vendimin e bordit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE) nr. 96, datë 17.06.2016; Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 23.08.2023, mbasi shqyrtoi relacionin me nr. 1711/2 prot., datë 18.08.2023, të përgatitur nga Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes “Mbi disa ndryshime në vendimin e bordit të ERE-s nr.195, datë 30.08.2018, “Mbi licencimin e shoqërisë “DERBI-E” sh.p.k. në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga HEC “Antena” me kapacitet të instaluar 1105kW”,

Konstatohet se:

- Bordi i ERE-s me vendimin nr. 195, datë 30.08.2018, ka vendosur:
 1. Të licencojë shoqërinë “Derbi -E” sh.p.k., në aktivitetin e prodhimit të energjisë elektrike nga Hec “Antena” me fuqi 1105 kW, për një afat 30 vjeçar.
 2. Shoqëria “Derbi -E” sh.p.k në përfundim të afati 5 - vjeçar të kontratës së qirasë me Bashkinë Mat, të depozitohet në ERE kontratën e rifreskuar.
- Në lidhje me kushtin e vendosur në pikën 2 të vendimit të bordit të ERE-s nr. 195/2018, shoqëria ka depozituar kontratën e rinovuar të qirasë me Bashkinë Mat për HEC “Antena”, me afat vlefshmërie 10 (dhjetë) vjet, deri më datë 07.04.2033, me të drejtë rinovimi.
- Ky afat nuk mbulon të gjithë afatin e vlefshmërisë së licencës së shoqërisë, ndaj vlerësohet që pika 2 e vendimit të bordit nr. 195/2018, të ndryshohet duke i lënë detyrë shoqërisë që të depozitohet në ERE kontratën e qirasë të rinovuar me Bashkinë Mat, jo më vonë se data 07.04.2033, ose çdo dokument tjetër që rregullon pronësinë në zonën ku shtrihet projekti.

- Me shkresën e depozituar në ERE me nr. 1116/4 prot., datë 11.04.2023 shoqëria ka depozituar lejen e përdorimit të burimit ujq sipërfaqësor me nr. Serie 000082, nr. 3 prot., datë 24.02.2023, të miratuar me vendimin nr.1, datë 08.02.2023, të Këshillit të Basenit Ujq Mat për përdorim të burimit ujq për HEC “Antena”, me një afat 5-vjeçar, deri më 08.02.2028.
- Shoqëria ka qënë e pajisur me leje për përdorimin e burimit ujq sipërfaqësor të vlefshme në momentin e aplikimit, për këtë arsye nuk i është lënë kusht në vendimin e bordit nr. 195/2018.
- Me depozitimin e lejes për përdorimin e burimit ujq sipërfaqësor, lind nevoja të shtohet një pikë në vendimin e licencimit, meqenëse kjo leje nuk mbulon të gjithë periudhën e licencimit dhe i nënshtrohet rinovimit, vlerësohet që t'i lihet kusht shoqërisë që të depozitohet në ERE lejen e rinovuar për përdorimin e burimit ujq sipërfaqësor për prodhim hidroenergje nga HEC “Antena” brenda datës 08.02.2028.
- Në nenin 113 të ligjit nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë” është parashikuar mundësia e ndryshimit të një akti, me nismën e vet organit që e ka nxjerrë, duke përcaktuar dhe formën ligjore të ndryshimit të aktit, e cila duhet të bëhet me një akt të ri me shkrim.

Për gjithë sa më sipër, bordi i ERE-s,

Vendosi:

1. Pika 2 e vendimit të bordit të ERE-s nr. 195, datë 30.08.2018, ndryshon dhe bëhet:

2. Shoqëria “DERBI-E” sh.p.k. duhet të depozitohet në ERE: kontratën e qirasë të rinovuar me Bashkinë Mat, jo më vonë se data 07.04.2033, ose çdo dokument tjetër që rregullon pronësinë në zonën ku shtrihet projekti si dhe lejen e rinovuar të përdorimit të burimit ujq sipërfaqësor për prodhim hidroenergje nga HEC “Antena” brenda datës 08.02.2028.
2. Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes, të njoftojë shoqërinë “DERBI-E” sh.p.k. për vendimin e bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Çdo palë e përfshirë në këtë procedurë mund t'i kërkojë ERE-s, brenda 7 ditëve kalendarike nga data e marrjes së vendimit, rishikimin e vendimit të bordit në rast se ka siguruar prova të reja që mund ta çojnë bordin në marrjen e një vendimi të ndryshëm nga i mëparshmi apo për gabime materiale të konstatuara. Për këtë vendim mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare

KRYETARI
Petrit AHMETI